LIGJ
Nr. 88/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9947, DATË 7.7.2008, "PËR PRONËSINË INDUSTRIALE", I NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 111/dh, paragrafi ekzistues numërtohet si pikë 1 dhe pas tij shtohet pika 2, si më poshtë:
"2. Masat, procedurat dhe mjetet juridike të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, duhet:
a) të jenë të drejta dhe të arsyeshme;
b) të mos jenë në mënyrë të panevojshme të ndërlikuara ose të kushtueshme, si dhe të mos përfshijnë afate të paarsyeshme kohore ose vonesa të pajustifikuara; dhe
c) të jenë të efektshme dhe me efekt parandalues.".

Neni 2

Në nenin 111/e shtohet pika 6, si më poshtë:
"6. Masat, procedurat dhe mjetet juridike të parashikuara në këtë nen zbatohen në një mënyrë, që:
a) është proporcionale;
b) shmang krijimin e pengesave për të legjitimuar tregtinë në tregun e brendshëm; dhe
c) parashikon masa mbrojtëse kundër abuzimit të tyre.".

Neni 3

Në nenin 111/g bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë:
"1. Gjykata, me kërkesën e mbajtësit të sekretit tregtar, urdhëron vendosjen e masave të përkohshme, me qëllim përfundimin ose ndërprerjen e veprimeve të përvetësimit, përdorimit ose bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar, duke përfshirë ndër të tjera:
a) ndërprerjen ose, sipas rastit, ndalimin e përdorimit, ose bërjes publike të sekretit tregtar në mënyrë të përkohshme;
b) ndalimin e prodhimit, ofrimit, hedhjes në treg ose përdorimit të mallrave cenuese, si dhe ndalimin e importimit, eksportimit apo ruajtjes së mallrave cenuese për këto qëllime;

[1] Ky ligj është përafruar plotësisht me Direktivën (BE) 2016/943, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 8 qershor 2016, "Mbi mbrojtjen e njohurive të fshehta dhe informacionit të biznesit (sekreteve tregtare) kundër përvetësimit, përdorimit dhe zbulimit të paligjshëm". Numri CELEX 32016L0943, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 157, datë 15.6.2016, faqe 1–18.

c) konfiskimin ose vënien nën kontroll të mallrave të dyshuara si cenuese deri në përfundim të procesit gjyqësor, duke përfshirë mallrat e importuar, në mënyrë që të ndalohet hyrja ose qarkullimi i tyre në treg.

ç) ndalimin e ofrimit ose sigurimit të shërbimeve që përdorin sekretin tregtar;

d) ruajtjen e provave të rëndësishme për shkeljen e pretenduar, me kusht që të mbrohet informacioni konfidencial;

dh) konfiskimin ose vënien nën kontroll të mjeteve të përdorura për prodhimin e mallrave të dyshuara si cenuese deri në përfundim të procesit gjyqësor;

e) urdhëron në rastin e një shkeljeje të kryer në shkallë tregtare dhe nëse pala e dëmtuar demonstron rrethana të tilla, që mund të rrezikojnë riparimin e dëmeve, bllokimin e përkohshëm të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shkelësit të pretenduar, përfshirë edhe bllokimin e llogarive të tij bankare dhe të aseteve të tjera. Për këtë qëllim, gjykata mund të urdhërojë paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, ose shfrytëzimin e mundësive të tjera, të përshtatshme, për të zotëruar informacionin përkatës.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, si më poshtë:

“5. Gjykata, si alternativë ndaj masave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, mund të kushtëzojë vazhdimin e përdorimit të sekretit tregtar që pretendohet si i paligjshëm me vendosjen e garancisë, me qëllim sigurimin e kompensimit të mbajtësit të sekretit tregtar. Bërja publike e sekretit tregtar në këmbim të vendosjes së garancisë nuk lejohet.”.

Neni 4

Në nenin 111/h bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Procedurat në rast shkeljeje dhe masat korrigjuese”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Mbajtësi i sekretit tregtar ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës kundrejt çdo personi që shkel të drejtat e tij për të kërkuar:

a) ndërprerjen e shkeljes ose, sipas rastit, ndalimin e përdorimit, ose bërjes publike të sekretit tregtar;

b) ndalimin e prodhimit, ofrimit, hedhjes në treg ose përdorimit të mallrave cenuese, si dhe ndalimin e importimit, eksportimit apo ruajtjes së mallrave cenuese për këto qëllime;

c) miratimin e masave korrigjuese në lidhje me mallrat cenuese;

ç) shkatërrimin tërësisht ose pjesërisht të çdo dokumenti, objekti, materiali, substance ose dosjeje elektronike që përmban ose përfshin sekretin tregtar ose, kur është e përshtatshme, vendosjen e të gjithë, ose një pjesë të këtyre dokumenteve, objekteve, materialeve, substancave ose dosjeve elektronike nën kontrollin e paditësit;

d) ndalimin e veprimeve të paautorizuara që shkaktojnë një rrezik serioz për përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar;

dh) heqjen ose bllokimin nga qarkullimi civil të mallrave cenuese, materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura për prodhimin e mallrave cenuese apo ofrimin e shërbimeve në mënyrë të paligjshme;

e) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata;

ë) shpërblimin e çdo dëmi të shkaktuar nga përvetësimi, përdorimi ose bërja publike në mënyrë të paligjshme e sekretit tregtar.”.

3. Në pikën 2, paragrafi i dytë shfuqizohet.

4. Pas pikës 2 shtohet pika 3, si më poshtë:

“3. Çdo masë e marrë nga gjykata dhe veçanërisht masat e parashikuara në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1 të këtij neni, do të kryhen me shpenzimet e shkelësit, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të veçanta për të mos vepruar në këtë mënyrë. Këto masa zbatohen pa cenuar çdo dëmshpërblim

që mund t'i detyrohet mbajtësit të sekretit tregtar për shkak të përvetësimit, përdorimit ose zbulimit të paligjshëm të sekretit tregtar.".

5. Pas pikës 3 shtohet pika 4 si më poshtë:

"4. Masat korrigjuese të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 1 të këtij neni përfshijnë:

a) tërheqjen e mallrave cenuese nga tregu;

b) heqjen e elementeve që përbëjnë shkelje tek mallrat cenuese;

c) shkatërrimin e mallrave cenuese ose, sipas rastit, largimin e tyre nga tregu, me kusht që ky largim të mos dëmtojë mbrojtjen e sekretit tregtar.".

Neni 5

Në nenin 111/i pas pikës 3 shtohet pika 4, si më poshtë:

"4. Me kërkesën e personit që mund t'u nënshtrohet masave të përcaktuara në nenin 111/h të këtij ligji, gjykata mund të vendosë pagimin e një kompensimi financiar në favor të palës së dëmtuar, në vend të zbatimit të këtyre masave, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) personi në fjalë, në kohën e përdorimit ose bërjes publike, nuk ishte në dijeni dhe as nuk mund të ishte në dijeni, sipas rrethanave, të faktit se sekreti tregtar ishte përfituar nga një tjetër person që ishte duke e përdorur ose e kishte bërë publike në mënyrë të paligjshme;

b) ekzekutimi i masave përkatëse do t'i shkaktonte këtij personi një dëm joproporcional; dhe

c) kompensimi financiar në favor të palës së dëmtuar paraqitet si mjaftueshëm i arsyeshëm.

Kur vendoset kompensimi financiar në vend të masave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 111/h të këtij ligji, ky kompensim nuk duhet të tejkalojë shumën e tarifave që do të ishin të pagueshme nëse personi në fjalë do të kishte kërkuar autorizim për përdorimin e sekretit tregtar në fjalë, për periudhën kohore gjatë së cilës përdorimi i sekretit tregtar mund të ishte ndaluar.".

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 471, datë 4.8.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.